



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E ADMINISTRIMIT TË BUXHETIT GJYQËSOR

Nr. Prot.

Tiranë, më _____ 2014

**Lënda: Mbi raportet e monitorimit për periudhën
janar - shtator 2014**

**Drejtuar: Ministrisë së Financave
Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit
Drejtorisë së Analizave dhe Politikave Buxhetore**

Në mbështetje të ligjit nr.185/2013 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2014", Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.2, datë 06.02.2012 "Proçedurat standarde të zbatimit të buxhetit" si dhe Udhëzimit Plotësues të Ministrit të Financave nr.3/1 datë 17.01.2014 "Për Zbatimin e Buxhetit të Vitit 2014", po ju raportojmë mbi performancën e produkteve të buxhetit për Pushtetin Gjyqësor, sipas programeve buxhetore të miratuara për periudhën janar - shtator 2014.

Programi - "Buxheti Gjyqësor"

Buxheti i akorduar për këtë program ka në bazë të tij Deklaratën e Politikës (DPP) të hartuar gjatë procesit të PBA 2014-2016. Ky program konsiston në mbështetjen buxhetore të shërbimeve gjyqësore dhe përmirësimin e infrastrukturës së gjykatave, me qëllim sjelljen e tyre në parametrat dhe cilësinë e performancës së ngjashme me vendet e Bashkimit Europian.

Buxheti i alokuar në këtë program është në funksion të realizimit të politikës së përcaktuar në DPP. Politika buxhetore e këtij programi, ka si qëllim kryesor arritjen e standarteve bashkohore në shërbimin gjyqësor nëpërmjet zhvillimit të infrastrukturës ndërtimore dhe elektronike të gjykatave, të cilat krijojnë kushte optimale pune dhe sigurie për gjyqtarët dhe stafin mbështetës si dhe zhvillimin e proçeseve gjyqësore dhe shërbimet e tjera ndaj publikut me cilësi dhe transparencë.

Gjithashtu ky buxhet ka për qëllim ndërmarrjen e veprimeve të caktuara në funksion të realizimit të produkteve dhe arritjes së objektivave të përcaktuara për këtë program buxhetor.

**Formati nr. 7 - Raporti i Shpenzimeve Faktike të Programit sipas Artikujve për periudhën
janar - shtator 2014.**

Me Ligjin Nr.185/2013, "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2014", fondet e akorduara për funksionimin e aktivitetit të gjykatave, sipas artikujve, paraqiten në vijim:

1-Shpenzime Personeli

Fondi i akorduar për periudhën janar - shtator për mbulimin e shpenzimeve në paga dhe sigurime shoqërore është 1,202,956 mijë lekë. Buxheti i rishikuar është 1,170,610 mijë lekë dhe realizimi paraqitet në masën 1,036,175 mijë lekë ose 86% e buxhetit të detajuar dhe 89% ndaj buxhetit të rishikuar.

Gjatë periudhës janar-shtator, gjykatat nuk kanë përdorur të plotë fondin e pagave dhe sigurimeve shoqërore, për shkak të mosplotësimit të strukturave organike.

Numri i punonjësve i miratuar me ligj për vitin 2014, nuk është plotësuar në të gjithë strukturat përbërëse të tij gjatë kësaj periudhe. Ka patur mungesa në mesatarisht 54 punonjës nga të cilat 20 administratë dhe 34 gjyqtarë të pa emëruar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Konkretisht, ka patur mungesa në strukturat organike në Gjykatën e Lartë, Gjykatat e Apeleve Vlorë, Durrës, Shkodër, Tiranë, Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Berat, Dibër, Fier, Gjirokastër, Korçë, Pogradec, Sarandë, Shkodër, Tiranë, Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, Gjykatat Administrative Gjirokastër, Korçë, Shkodër dhe Vlorë.

Në momentin e detajimit të buxhetit, nuk ishte detajuar numri shtesë i miratuar, 94 punonjës. Ky numër kishte të bënte me nevojën për 11 punonjës të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, 28 ndihmësa ligjorë për gjykatat administrative si dhe 55 punonjës administrate për gjykatat administrative dhe gjykatat e tjera. Numri shtesë i padetajuar së bashku me buxhetin përkatës u mbajt rezervë në Z.A.B.GJ. në programin 03310 “Buxheti Gjyqësor”.

Me miratimin nga Ministria e Drejtësisë të strukturave të reja organike, në muajin mars, u detajua një pjesë e fondit rezervë për plotësimin e efekteve shtesë të rritjes së numrit të punonjësve në gjykatat administrative dhe gjykata të tjera.

Marrë në konsideratë fondin e lirë të krijuar si më sipër si dhe nevojat emergjente të gjykatave administrative dhe gjykatave të tjera për buxhet shtesë në shpenzime operative, Ministri i Financave, bazuar në argumentat e paraqitura nga Zyra, miratoi transferimin e fondit 30,000 mijë lekë nga “Paga” në “Shpenzime operative”.

Gjithashtu një pjesë e fondit të lirë të krijuar në shpenzime personeli, në vlerë 32,138 mijë lekë, u pakësua me Aktin Normativ nr. 1 datë 17.09.2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 185/2013 datë 28.12.2013 “Për buxhetin e vitit 2014”.

Në rast të mosplotësimit në vazhdimësi të strukturave organike në gjykata mund të krijohen fonde të tjera të lira deri në fund të vitit.

2-Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera

Fondi i akorduar për periudhën janar - shtator është 263,505 mijë lekë, ndërsa buxheti i rishikuar është 311,205 mijë lekë. Realizimi i këtij artikulli paraqitet në vlerën 268,682 mijë lekë ose 86% e buxhetit të rishikuar dhe 102% ndaj buxhetit të detajuar në fillim të vitit.

Arsyeja kryesore e realizimit në këtë masë të buxhetit në shpenzime operative për këtë periudhë, janë procedurat e prokurimit të cilat parashikohet të përfundojnë gjatë muajve në vijim.

Procedurat për prokurimin e fondeve të planifikuara për disa gjykata në këtë periudhë për tonera, karburant, goma, ruajtjen e godinave të gjykatave, etj. janë në proces për t'u përfunduar, duke ndikuar kështu në performancën e shpenzimeve operative për 9/mujorin. Buxheti i miratuar në shpenzime operative për vitin 2014, është plotësisht i nevojshëm në funksion të aktivitetit të gjykatave dhe deri në fund të vitit garantohej realizimi i plotë i tij.

Në gjykatat, të cilat nuk kanë mundur të realizojnë perfundimin në kohë të procedurave të prokurimit, ky realizim është në nivel jo të plotë dhe këtu përmendim: Gjykatën e Apelit Durrës, Shkodër, Gjirokastrë, Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Dibër, Krujë, Kukës Shkoder dhe ZABGj për programin “Buxheti Gjyqësor”, si dhe të gjitha Gjykatat Administrative.

Pjesa tjetër e gjykatave kanë arritur të realizojnë përdorimin e plotë të fondeve të planifikuara si: Gjykata e Lartë, Gjykata e Apelit Tiranë, Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda, Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Fier, Kurbin, Lushnje, Mat, Pogradec, Gjykata Administrative e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Shkalles së Parë për Krimet e Rënda.

Gjithashtu në fondin për shpenzime operative për 9/mujorin është përfshirë edhe transferimi i realizuar në muajin Maj, në vlerë 30 milion lekë, i cili është bërë efektiv për t'u përdorur nga gjykatat në muajin korrik dhe është planifikuar të përdoret edhe për muajt e tjerë në vazhdim.

3- Shpenzime në investime

Fondi i investimeve akorduar nga buxheti i shtetit për këtë program është 115,170 mijë lekë, ndërsa realizimi 52,478 mijë lekë ose 46% .

në mijë/lekë

Projekti	Plan	Fakt	%
1. Ndertim	24,000	0	0%
2. Automjet	6,000	5,997	100%
3. Rikonstruksion	26,800	6,143	23%
4. Pajisje - Mobilje	56,070	40,116	72%
5. Projekt	2,300	222	10%
TOTALI	115,170	52,478	46%

“Ndërtim”

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit në projektin “Ndërtim” për periudhën janar-shtator është 24,000 mijë lekë. Ky fond është detajuar për fillimin e zbatimit të punimeve për ndërtimin e godinës së re të Gjykatës së Apelit Shkodër. Ky projekt është parashikuar të shtrihet në disa vite dhe fondi i miratuar për vitin 2014 është 42.000 mijë lekë. Gjykata ka përfunduar procedurat e prokurimit dhe është në fazën e lidhjes së kontratës.

“Rikonstruksion”

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit në projektin “ Rikonstruksion” për periudhën janar-shtator, është 26,800 mijë lekë dhe realizimi 6,143 mijë lekë ose 23% e buxhetit të detajuar për këtë periudhë. Ky fond është planifikuar të realizohet në 11 gjykata, konkretisht :

- Për Gjykatën e Apelit Durrës, për periudhën janar-shtator është detajuar një fond 3,000 mijë lekë, për rikonstruksionin e pjesshëm të godinës, me qëllim shtimin e ambienteve të nevojshme të punës për gjyqtarët e shtuar në organikë, si dhe krijimin e një sallë gjyqi shtesë, me një fond total 6.480 mijë lekë. Gjykata ka përfunduar procedurat e prokurimit, vazhdojnë punimet dhe likuidimi sipas situacioneve të punimeve.
- Për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, për periudhën janar-shtator është detajuar një fond 11,500 mijë lekë, për kryerjen e punimeve për krijimin e ambientit të shërbimit për publikun dhe aksesin për personat me aftësi të kufizuar. Gjykata pasi ka përfunduar procedurat e prokurimit, ka lidhur kontratën me operatorin ekonomik fitues, është duke filluar punimet.
- Për Gjykatën e Apelit Vlorë, është detajuar fondi 200 mijë lekë për kryerjen e punimeve për përshtatjen e ambienteve dhe krijimin e zyrave për 2 gjyqtarët shtesë në organikë. Ky fond nuk është prokuruar nga gjykata pasi nuk u bë i mundur kalimi i këtyre ambienteve. Në muajin Tetor është realizuar transferimi i tij për nevoja të tjera të paraqitura nga gjykata.
- Për Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë, për periudhën janar-shtator është detajuar fondi 5,000 në mije lekë, kurse fondi total i miratuar për vitin 2014 është 8,480 mijë lekë. Fillimisht u parashikua rikonstruksion i godinës ekzistuese të gjykatës. Më pas, për shkak të pamjaftueshmërisë së ambienteve, nga gjykata në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, është bërë e mundur sigurimi i një godine tjetër për tu rikonstruktuar dhe përshtatur për nevoja të gjykatës (godina e ish- Drejtorisë së Konvikteve të Shkollave të Mesme të Tiranës). Me fondet në dispozicion për vitin 2014, do të realizohet hartimi i projektit teknik, për të cilin kanë filluar procedurat e prokurimit. Pjesa tjetër e fondit është transferuar nga Ministria e Financave në muajin Tetor.
- Për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, për periudhën janar-shtator është detajuar një fond në vlerën 1.400 mijë lekë. Ka përfunduar kryerja e disa punimeve përmirësuese, për aq sa lejon infrastruktura ndërtimore e saj, të tilla si: rregullimi i hyrjes kryesore të godinës, riparim i fasadës dhe rrethimi i godinës së gjykatës. Gjykata është në proces likuidimi.
- Për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, për periudhën janar-shtator është detajuar fondi në vlerën 550 mijë lekë, për të kryer punime në nivel mirëmbajtje për hidroizolim të tarracës së godinës së gjykatës. Procesi i prokurimit i zhvilluar në datën 10 shtator ka dështuar për mos pjesmarje të ofertuesve dhe në këto kushte gjykata do të përsërisë prokurimin për herën e dytë.
- Për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë, është detajuar fondi 450 mijë lekë, për krijimin e aksesit për personat me aftësi të kufizuar. Për shkak të pamundësisë të realizimit të këtij investimi, ky fond është transferuar nga Ministria e Financave në muajin Tetor, për disa nevoja të tjera të paraqitura nga kjo gjykatë.
- Për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë është detajuar një fond për të bërë një investim për zgjerimin e arkivës si dhe krijimin e aksesit për personat me aftësi të kufizuar, si dhe përmirësimin e ambientit të shërbimit për publikun, në vlerë 2.130 mijë lekë. Gjykata ka përfunduar një pjesë të këtij investimi dhe është në proces për finalizimin e tij.

- Për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë, është detajuar fondi 1,640 mijë lekë për pagesën e supervisorit dhe kolaudatorit si dhe për përfundimin e likuidimit të punimeve për rikonstruksionin e plotë të godinës së kësaj gjykate, të shtrirë në dy vite 2012-2013. Ka përfunduar likuidimi i fondit të detajuar për këtë qëllim.
- Për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, është detajuar fondi 450 mijë lekë, për përshtatje të ambjenteve të Zyrës Vendore të Përmbartimit Durrës, ku do të vendoset gjykata . Ka përfunduar prokurimi dhe likuidimi i fondit.
- Për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, është detajuar një fond në masën 480 mijë lekë, për përshtatjen e ambjenteve ku është akomoduar gjykata. Gjykata ka përfunduar një pjesë të këtij investimi dhe është në proces për finalizimin e tij.

“Automjet”

Fondi i akorduar nga Buxheti i Shtetit në projektin “Automjet” për periudhën janar-shtator është 6,000 mijë lekë. Fondi u detajua për Gjykatën e Lartë për blerjen e tre autoveturave. Gjykata ka përfunduar procesin e prokurimit dhe likuidimit 100%.

"Paisje Mobilje"

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit për 9/mujorin, është 56,070 mijë lekë dhe realizimi 40,116 mijë lekë ose 72% e buxhetit të detajuar për këtë periudhë. Fondi i realizuar ka të bëjë me likuidimet që kanë kryer gjykatat për prokurimet më vlerë të vogël, për blerje paisje e mobilje. Pjesa tjetër e gjykatave janë në proces.

Për periudhën 9/mujore, situata e investimeve për këtë projekt, sipas grupeve kryesore të pajisjeve, paraqitet si më poshtë:

✚ *“Paisje elektronike”*. Fondi i detajuar është 37,433 mijë lekë ndërsa realizimi 28,147 mijë lekë ose 75%.

a) Kanë përfunduar procedurat e prokurimit dhe janë në proces likuidimi:

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë me fondin 400 mijë lekë.
- Gjykata Administrative e Shkallës Parë Durrës, me fondin 2,200 mijë lekë.
- Gjykata Administrative e Shkallës Parë Vlorë, me fondin 1.260 mijë lekë.
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër me fondin 240 mijë lekë.

b) Kanë përfunduar procedurat e prokurimit dhe janë duke lidhur kontratën:

- Gjykata e Lartë, me fondin 2,000 mijë lekë
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Laç me fondin 850 mijë lekë.

✚ *Mobilje* . Fondi i detajuar për 9/mujorin është 13,777 mijë lekë kurse realizimi 10,462 mijë lekë ose 76%.

a) Kanë përfunduar procedurat e prokurimit dhe janë në proces likuidimi:

- Gjykata e Apelit Durrës me fondin 150 mijë lekë.
- Gjykata Administrative Shkallës Parë Durrës me fondin 650 mijë lekë.

b) Ka filluar procedurat e prokurimit dhe përgatitjen e dokumentave, Gjykata e Lartë me fondin 630 mijë lekë.

c) Nuk është realizuar prokurimi dhe në muajin Tetor është kryer miratimi i transferimit për nevoja të gjykatave të tjera, të fondeve të detajuara për :

- Gjykata e Apelit Administrativ Tiranë me fondin 770 mijë lekë.
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë me fondin 100 mijë lekë.

✚ *“Paisje siguriye”*. Fondi i detajuar është 1,390 mijë lekë ndërsa realizimi 1,095 mijë lekë ose 79%. Ky fond u detajua për plotësimin e nevojave për pajisje sigurie për gjykatat. Diferenca e fondit vjen nga procesi i prokurimit.

✚ *“Paisje te tjera”* Fondi i detajuar për 9/mujorin është 3,470 mijë lekë kurse realizimi 411 mijë lekë.

a) Ka përfunduar procedurat e prokurimit dhe ka lidhur lidhur kontratën, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Laç me fondin 1,600 mijë lekë (gjenerator).

b) Është duke përsëritur tenderin për herën e dytë, Gjykata e Shkallës Parë për Krimet e Rënda, me fondin 620 mijë lekë.

c) Kanë filluar procedurat dhe përgatitjen e dokumentave:

- Gjykata e Larte me fondin 570 mijë lekë.
- Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda, me fondin 180 mijë lekë.

"Projekt".

✚ Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit për këtë zë të investimeve është 2,300 mijë lekë kurse realizimi 222 mijë lekë. Ky buxhet është detajuar për 3 gjykata, konkretisht:

- Për Gjykatën e Apelit Durrës është detajuar fondi 480 mijë lekë për hartimin e projekt-preventivit për rikonstrukcion të pjesshëm të godinës. Gjykata ka përfunduar procedurat e prokurimit dhe likujdimit.
- Për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë është detajuar fondi 1.340 mijë lekë, për hartimin e projektit për rikonstrukcion të ambjenteve të godinës së KESH –it, kaluar me vendim të Këshillit të Ministrave për gjykatën. Kanë përfunduar procedurat e prokurimit për fazën e parë, kurse për prokurimin e fazës së dytë, është kryer vleresimi dhe është duke u shpallur fituesi.
- Për Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë, kanë filluar procedurat e prokurimit për hartimin e projektit për rikonstrukcion të godinës së transferuar për këtë gjykatë.

Formati nr. 8 - Raporti i shpenzimeve sipas Programeve

Buxheti i detajuar për periudhën janar- shtator 2014, në fillim të vitit për këtë program është 1,581,631 mijë lekë dhe realizimi 1,360,188 mijë lekë ose 86 %.

Në këtë realizim kanë ndikuar disa faktorë:

- Mospërdorimi i plotë i fondit për shpenzime personeli. Gjatë periudhës janar - shtator, ka patur mosplotësime të strukturave organike në disa gjykata konkretisht, në Gjykatën e Lartë, Gjykatat e Apeleve Vlorë, Durrës, Shkodër, Tiranë, Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Berat, Dibër, Fier, Gjirokastër, Korçë, Pogradec, Sarandë, Shkodër, Tiranë, Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, Gjykatat Administrative Gjirokastër, Korçë, Shkodër dhe Vlorë. Gjithashtu detajimi i numrit shtesë të punonjësve miratuar me ligjin e buxhetit për vitin 2014, është realizuar në muajin Mars, duke ndikuar në përdorimin jo të plotë të buxhetit të planifikuar për këtë periudhë.
- Moskryerja e likujdimit për të gjitha shpenzimet e kryera nga gjykatat, në shpenzime operative për shkak se gjykatat janë në proces për prokurimin e fondeve të planifikuara për shtypshkrime, kancelari, letër, tonera, karburant, goma etj.
- Edhe për buxhetin në investime, gjykatat janë duke kryer procedurat e prokurimit dhe të likujdimit për fondet e detajuara për këtë periudhë.

Formati nr.9 - Raporti i Realizimit të Produkteve të Programit

Programi “Buxheti Gjyqësor” për periudhën janar - shtator 2014 përbëhet nga disa produkte, të cilat janë në funksion të realizimit të objektivave të përcaktuar në Deklaratën e Politikës së Programit (DPP). Në funksion të objektivit të parë të DPP-se, janë përcaktuar disa produkte, realizimi sasior i të cilëve paraqitet si më poshtë:

Produkti A “Çështje të gjykuara në vit”- Njësia matëse nr.çështjesh.

Numri i çështjeve të parashikuara për periudhën janar - shtator 2014 është 116,455. Ky parashikim nga ana e gjykatave është kryer referuar tendencës së numrit të çështjeve për disa vite. Për këtë periudhë janë gjykuar plotësisht 104,404 çështje dhe janë në proces për t'u gjykuar 12,051 çështje. Nga një këndvështrim i përgjithshëm, në realizimin sasior të këtij produkti ka ndikuar mosplotësimi i strukturave organike në disa gjykata. Por, duhet të merret në konsideratë edhe fakti që në realizimin e çështjeve gjyqësore ndikojnë edhe një sërë faktorësh të tjerë proceduriale apo substanciale që paraqiten specifike për çdo çështje.

Produkti B- “Sipërfaqe godine e re” - Njësia matëse m².

Në këtë produkt është planifikuar të realizohet ndërtimi i godinës së re, në Gjykatën e Apelit Shkodër. Ky projekt është parashikuar të shtrihet në disa vite dhe fondi i miratuar për vitin 2014 është 42.000 mijë lekë. Gjykata ka përfunduar procedurat e prokurimit dhe është në fazën e lidhjes së kontratës.

Produkti D - “Projekt zbatim për rikonstrukcion të plotë të godinave të gjykatave”. Njësia matëse - nr. institucioni.

Në këtë produkt për periudhën janar - shtator është parashikuar realizimi i projekt- preventivit për rikonstruksion të plotë të godinave të gjykatave në 3 institucione dhe konkretisht është realizuar:

- Plotësisht në 1 institucion.
- Pjesërisht në 2 institucione.

Për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë është detajuar një fond, për hartimin e projektit për rikonstruksion të ambjenteve të godinës së KESH –it. Kanë përfunduar procedurat e prokurimit për fazën e parë, kurse për prokurimin e fazës së dytë, është kryer vleresimi dhe është duke u shpallur fituesi.

Për Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë, kanë filluar procedurat e prokurimit për hartimin e projektit për rikonstruksion të godinës së transferuar për këtë gjykatë.

Produkti E- “Sipërfaqe godine e rikonstruktuar” - Njësia matëse m².

Në këtë produkt për periudhën janar - shtator është parashikuar të realizohet 502 m² sipërfaqe godine e rikonstruktuar plotësisht, kurse janë realizuar vetëm 28 m². Nuk është realizuar plotësisht në terma sasiorë rikonstruksioni. Konkretisht është kjo situatë;

- Plotësisht në 2 institucione.
- Pjesërisht në 6 institucione
- Aspak në 3 institucione.

Fondi për 3 gjykatat; Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë, Gjykatën e Apelit Vlorë, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë është transferuar nga Ministria e Financave në muajin Tetor, për disa nevoja të tjera të paraqitura nga këto gjykata.

Produkti F “Mobilje për zyra dhe salla gjyqi për gjykatat ” - Njësia matëse nr. institucioni.

Në këtë produkt për periudhën janar - shtator, është parashikuar realizimi i mobiljeve për zyra dhe salla gjyqi, për 15 institucione dhe konkretisht është realizuar:

- Plotësisht në 11 institucione.
- Pjesërisht në 3 institucione.
- Aspak në 2 institucione

Gjykata e Apelit Administrativ Tiranë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë nuk realizuan prokurimin dhe në muajin Tetor është kryer miratimi i transferimit të fondit për nevoja të gjykatave të tjera.

Produkti G -“Elementë sigurie për gjykatat”- Njësia matëse nr. institucioni.

Ky produkt është realizuar plotësisht në 3 institucione. Në këtë produkt bëjnë pjesë Gjykata e Lartë si dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, të cilat kanë prokuruar kamera vëzhgimi si edhe Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda, e cila ka prokuruar për emergjence për paisje sigurie.

Produkti H -“Paisje të tjera në funksion të aktivitetit të gjykatave”- Njësia matëse nr. Institucioni.

Në këtë produkt për periudhën janar - shtator është parashikuar realizimi i disa paisjeve të tjera të domosdoshme për aktivitetin e gjykatës. Ky produkt është parashikuar të realizohet në 4 institucione.

- Plotësisht në 1 institucion.
- Pjesërisht në 3 institucione.

Gjykata e Lartë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Laç dhe Gjykata e Shkallës Parë për Krimet e Rënda, kanë filluar procedurat për prokurimin e fondeve dhe realizimin e produktit.

Produkti I -“Automjete për gjykatat”- Njësia matëse nr.automjete

Në këtë produkt është parashikuar blerja e tre autoveure për Gjykatën e Lartë. Ky produkt është realizuar plotësisht.

Në funksion të objektivit të dytë të DPP-se, janë përcaktuar dy produkte, ku për periudhën janar-shtator, realizimi sasior paraqitet si më poshtë:

Produkti J -“Paisje elektronike për gjykatat” -Njësia matëse për këtë produkt “nr.institucioni”.

Në këtë produkt për periudhën janar - shtator është parashikuar realizimi i pajisjeve elektronike për 35 institucione dhe realizimi paraqitet:

- Plotësisht në 30 institucione.
- Pjesërisht në 5 institucione.

Pesë gjykatat kanë përfunduar procesin e prokurimit dhe janë në vazhdim të realizimit të fondit.

Në funksion të objektivit të tretë të DPP-se, është përcaktuar një produkt, realizimi sasior paraqitet si më poshtë:

Produkti K -“Gjyqtare të trajnuar për anën profesionale të tyre” - Njësia matëse nr.gjyqtarësh.

Në këtë produkt për periudhën 9/mujore është parashikuar mbështetja me buxhet për shpenzimet udhëtim e dieta për trajnimin profesional të 73 gjyqtarëve nga Shkolla e Magjistraturës, ndërkohe që janë realizuar trajnime për 62 gjyqtarë. Për këtë produkt shpjegojmë se trajnimet janë kryer nga Shkolla e Magjistratures, në bazë të detyrimit ligjor që ka ky institucion.

Produkti L -“ Konferencë Gjyqësore Kombëtare” - Njësia matëse nr.konference.

Në këtë produkt është parashikuar realizimi i Konferencës Gjyqësore Kombëtare, produkt i cili është realizuar plotësisht.

Formati nr.10- Raporti i Shpenzimeve Faktike të Programit sipas Produkteve

Programi 03310 “Buxheti Gjyqësor” për periudhën janar-shtator 2014 përbëhet nga disa produkte të cilat janë në funksion të realizimit të objektivave të përcaktuar në Deklaratën e Politikës së Programit (DPP). Në funksion të objektivit të parë të DPP-së, janë përcaktuar disa produkte, realizimi vleror i të cilëve paraqitet si më poshtë:

Produkti A - “Çështje të gjykuara në vit”. Buxheti për këtë produkt për periudhën janar – shtator 2014, është planifikuar në shumën 1,461,886 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 1,303,687 mijë lekë ose 89%. Në këtë realizim kanë ndikuar disa faktorë:

- Mospërdorimi i plotë i fondit për shpenzime personeli. Gjatë periudhës janar - shtator, ka patur mosplotësime të strukturave organike në disa gjykata si në: Gjykatën e Lartë, Gjykatat e Apeleve Vlorë, Durrës, Shkodër, Tiranë, Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Berat, Dibër, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Pogradec, Sarandë, Shkodër, Tiranë, Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, Gjykatat Administrative Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Vlorë.

Gjithashtu detajimi i numrit shtesë të punonjësve miratuar me ligjin e buxhetit për vitin 2014, është realizuar në muajin Mars, duke ndikuar në përdorimin jo të plotë të buxhetit të planifikuar për këtë periudhë.

- Gjatë periudhës janar-shtator janë në proces të përfundimit të procedurave për prokurimin apo edhe në proces likuidimi të fondeve të planifikuara nga gjykatat për shtypshkrime, kancelari, letër, tonera, karburant, goma etj, duke ndikuar kështu në performancën e shpenzimeve operative për këtë periudhë.

Produkti B - “Sipërfaqe godine e re”

Në këtë produkt është planifikuar të realizohet ndërtimi i godinës së re, në Gjykatën e Apelit Shkodër. Ky projekt është parashikuar të shtrihet në disa vite dhe fondi i miratuar për vitin 2014 është 42.000 mijë lekë. Gjykata ka përfunduar procedurat e prokurimit dhe është në fazën e lidhjes së kontratës.

Produkti D - “Projekt zbatim për rikonstrukcion të plotë të godinave të gjykatave”.

Në këtë produkt për periudhën për periudhën janar-shtator është parashikuar një buxhet në vlerën 2,300, kurse realizimi i produktit është në vlerën 222 mijë lekë. Për këtë produkt shpjegojmë: Ky buxhet është detajuar për 3 gjykata, konkretisht:

- Për Gjykatën e Apelit Durrës është detajuar fondi 480 mijë lekë për hartimin e projekt-preventivit për rikonstrukcion të pjesshëm të godinës. Gjykata ka përfunduar procedurat e prokurimit dhe likuidimit.
- Për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë është detajuar fondi 1.340 mijë lekë, për hartimin e projektit për rikonstrukcion të ambjenteve të godinës së KESH –it, kaluar me vendim të Këshillit të Ministrave për gjykatën. Kanë përfunduar procedurat e prokurimit për fazën e parë, kurse për prokurimin e fazës së dytë, është kryer vleresimi dhe është duke u shpallur fituesi.
- Për Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë, kanë filluar procedurat e prokurimit për hartimin e projektit për rikonstrukcion të godinës së transferuar për këtë gjykatë.

Produkti E- “Sipërfaqe godinë e rikonstruktuar” - Buxheti për këtë produkt për periudhën janar-shtator është 27,660 mijë lekë dhe realizimi 6,143 mijë lekë. Ky fond është planifikuar të realizohet në 11 gjykata, konkretisht :

- Për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë, është detajuar fondi 1,640 mijë lekë për pagesën e supervisorit dhe kolaudatorit si dhe për përfundimin e likuidimit të punimeve për rikonstrukcionin e plotë të godinës së kësaj gjykate, të shtrirë në dy vite 2012-2013. Ka përfunduar likuidimi i fondit të detajuar për këtë qëllim.

- Për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, është detajuar fondi 450 mijë lekë, për përshtatje të ambjenteve të Zyrës Vendore të Përmbarimit Durrës, ku do të vendoset gjykata . Ka përfunduar prokurimi dhe likujtimi i fondit.
- Për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë është detajuar një fond për të bërë një investim për zgjerimin e arkivës si dhe krijimin e aksesit për personat me aftësi të kufizuar si dhe përmirësimin e ambjentit të shërbimit për publikun, në vlerë 2.130 mijë lekë. Gjykata ka përfunduar një pjesë të këtij investimi dhe është në proces për finalizimin e tij.
- Për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, është detajuar një fond në masën 480 mijë lekë, për përshtatjen e ambjenteve ku është akomoduar gjykata. Gjykata ka përfunduar një pjesë të këtij investimi dhe është në proces për finalizimin e tij.
- Për Gjykatën e Apelit Durrës, për periudhën janar-shtator është detajuar një fond 3,000 mijë lekë, për rikonstrukcionin e pjesshëm të godinës, me qëllim shtimin e ambjenteve të nevojshme të punës për gjyqtarët e shtuar në organikë si dhe krijimin e një sallë gjyqi shtesë, me një fond total 6.480 mijë lekë. Gjykata ka përfunduar procedurat e prokurimit, vazhdojnë punimet dhe likujtimi sipas situacioneve të punimeve.
- Për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, për periudhën janar-shtator është detajuar një fond në vlerën 1.400 mijë lekë. Ka përfunduar kryerja e disa punimeve përmirësuese, për aq sa lejon infrastruktura ndërtimore e saj, të tilla si: rregullimi i hyrjes kryesore të godinës, riparim i fasadës dhe rrethimi i godinës së gjykatës. Gjykata është në proces likujtimi.
- Për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, për periudhën janar-shtator është detajuar një fond 11,500 mijë lekë, për kryerjen e punimeve për krijimin e ambjentit të shërbimit për publikun dhe aksesin për personat me aftësi të kufizuar. Gjykata pasi ka përfunduar procedurat e prokurimit, ka lidhur kontratën me operatorin ekonomik fitues, është duke filluar punimet.
- Për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, për periudhën janar-shtator është detajuar fondi në vlerën 550 mijë lekë, për të kryer punime në nivel mirëmbajtje për hidroizolim të tarracës së godinës së gjykatës. Procesi i prokurimit i zhvilluar në datën 10 shtator ka dështuar për mos pjesmarje të ofertuesve dhe në këto kushte gjykata do të përsërisë prokurimin për herën e dytë.
- Për Gjykatën e Apelit Vlorë, është detajuar fondi 200 mijë lekë për kryerjen e punimeve për përshtatjen e ambjenteve dhe krijimin e zyrave për 2 gjyqtarët shtesë në organikë. Ky fond nuk është prokuruar nga gjykata pasi nuk u bë i mundur kalimi i këtyre ambjenteve. Në muajin Tetor është realizuar transferimi i tij për nevoja të tjera të paraqitura nga gjykata.
- Për Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë, për periudhën janar-shtator është detajuar fondi 5,000 në mije lekë, kurse fondi total i miratuar për vitin 2014 është 8,480 mijë lekë. Fillimisht u parashikua rikonstrukcion i godinës ekzistuese të gjykatës. Më pas, për shkak të pamjaftueshmërisë së ambjenteve, nga gjykata në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, është bërë e mundur sigurimi i një godine tjetër për tu rikonstruktuar dhe përshtatur për nevoja të gjykatës (godina e ish- Drejtorisë së Konvikteve të Shkollave të Mesme të Tiranës). Me fondet në dispozicion për vitin 2014, do të realizohet hartimi i projektit teknik, për të cilin kanë filluar procedurat e prokurimit. Pjesa tjetër e fondit është transferuar nga Ministria e Financave në muajin Tetor.
- Për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë, është detajuar fondi 450 mijë lekë, për krijimin e aksesit për personat me aftësi të kufizuar. Për shkak të pamundësisë të realizimit të këtij investimi, ky fond është transferuar nga Ministria e Financave në muajin Tetor, për disa nevoja të tjera të paraqitura nga kjo gjykatë.

Produkti F- “Mobilje për zyra dhe salla gjyqi për gjykatat ”. Buxheti për këtë produkt është 13,110 mijë lekë, kurse realizimi paraqitet në masën 10,463 mijë lekë, ose 80%.

- a) Kanë përfunduar procedurat e prokurimit dhe janë në proces likuidimi:
 - Gjykata e Apelit Durrës me fondin 150 mijë lekë.
 - Gjykata Administrative Shkallës Parë Durrës me fondin 650 mijë lekë.
- b) Ka filluar procedurat e prokurimit dhe përgatitjen e dokumentave, Gjykata e Lartë me fondin 630 mijë lekë.
- c) Nuk është realizuar prokurimi dhe në muajin Tetor është kryer miratimi i transferimit për nevoja të gjykatave të tjera, të fondeve të detajuara për :
 - Gjykata e Apelit Administrativ Tiranë me fondin 770 mijë lekë.
 - Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë me fondin 100 mijë lekë.

Produkti G -“Elementë sigurie për gjykatat”. Në këtë produkt periudhën janar- shtator është parashikuar një buxhet në vlerën 1,350 mijë lekë, kurse realizimi 1095 mijë lekë, ose 81%. Ky fond u detajua për plotësimin e nevojave për pajisje sigurie për gjykatat. Diferenca e fondit vjen nga procesi i prokurimit.

Produkti H -“Pajisje të tjera në funksion të aktivitetit të gjykatave”. Për këtë produkt është parashikuar buxhet për periudhën për 9/mujore në vlerën 3,290 mijë lekë, kurse realizimi 411 mijë lekë.

- a) Ka përfunduar procedurat e prokurimit dhe ka lidhur kontratën, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Laç me fondin 1,600 mijë lekë (gjenerator).
- b) Është duke përsëritur tenderin për herën e dytë, Gjykata e Shkallës Parë për Krimet e Rënda, me fondin 620 mijë lekë.
- c) Ka filluar procedurat dhe përgatitjen e dokumentave, Gjykata e Lartë me fondin 570 mijë lekë.

Produkti I -“Automjete për gjykatat

Fondi i akorduar nga Buxheti i Shtetit në projektin “Automjet” për periudhën janar-shtator është 6,000 mijë lekë. Fondi u detajua për Gjykatën e Lartë për blerjen e tre autoveturave. Gjykata ka përfunduar procesin e prokurimit dhe likuidimit 100%.

Në funksion të objektivit të dytë të DPP-se, është përcaktuar një produkt, realizimi vleror i të cilit paraqitet si më poshtë:

Produkti J -“Pajisje elektronike për gjykatat”. Buxheti për periudhën 9/mujore për këtë produkt është 37,460 mijë lekë, ndërsa është realizuar 28,147 mijë lekë ose 75%. Për realizimin e produktit spjegojme:

- a) Kanë përfunduar procedurat e prokurimit dhe janë në proces likuidimi:

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë me fondin 400 mijë lekë.
- Gjykata Administrative e Shkallës Parë Durrës, me fondin 2,200 mijë lekë.
- Gjykata Administrative e Shkallës Parë Vlorë, me fondin 1.260 mijë lekë.
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër me fondin 240 mijë lekë.

b) Kanë përfunduar procedurat e prokurimit dhe janë duke lidhur kontratën:

- Gjykata e Lartë, me fondin 2,000 mijë lekë
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Laç me fondin 850 mijë lekë.

Në funksion të objektivit të tretë të DPP-se, janë përcaktuar dy produkte, ku për periudhën janar-qershor, realizimi vleror paraqitet si më poshtë:

Produkti K- “Gjyqtarë të trajnuar për anën profesionale të tyre”. Ky produkt për periudhën janar-shtator është parashikuar në masën 2,575 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën prej 2,339 mijë lekë, ose 91%.

Produkti L -“ Konferencë Gjyqësore Kombëtare”. Për këtë produkt është parashikuar buxhet për periudhën janar - shtator në vlerën 2,000 mijë lekë, dhe realizimi është 1,684 mijë lekë. Produkti është realizuar plotësisht.

Programi- “Planifikim menaxhim dhe administrim ”

Buxheti i akorduar për këtë program ka në bazë të tij Deklaratën e Politikës (DPP). Ky buxhet është në funksion të realizimit të politikës së përcaktuar në DPP; harmonizimi i nevojave të gjykatave me burimet financiare në dispozicion për pushtetin gjyqësor, në funksion të mbështetjes së shërbimeve gjyqësore, përmirësimit tërësor të infrastrukturës së gjykatave për realizimin e proceseve gjyqësore dhe rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj publikut. Kjo politikë ka si qëllim kryesor, menaxhimin me efektivitet dhe efikasitet të fondeve buxhetore, që miratohen për Pushtetin Gjyqësor për të siguruar pavaresinë financiare të Gjyqësorit .

Formati nr. 7 - Raporti i Shpenzimeve Faktike të Programit sipas Artikujve për periudhën janar - shtator 2014.

Me Ligjin Nr.185/2013, "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2014", Zyrës të Administrimit të Buxhetit Gjyqësor i janë akorduar fondet, sipas artikujve si më poshtë:

1.Shpenzime Personeli

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit si dhe buxheti i rishikuar për periudhën janar - shtator, për mbulimin e shpenzimeve në paga dhe sigurime shoqërore është 18,124 mijë lekë, kurse realizimi është 14,359 mijë lekë ose 79% e buxhetit të detajuar dhe të rishikuar. Ky realizim vjen pasi deri në muajin mars ka pasur mosplotësim të strukturës të ZABGJ-së me dy punonjës.

2.Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit për periudhën janar-shtator për vitin 2014 është 4,100 mijë lekë. Buxheti i rishikuar është 4,068 mijë lekë. Realizimi i këtij artikulli paraqitet në vlerën 2,758 mijë lekë, ose 67% ndaj buxhetit të planifikuar, si dhe 68% të buxhetit të rishikuar. Në realizimin e zërit “Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera” kane ndikuar:

-Moslikujdimi i zërit ”mirëmbajtje dhe hostim të faqes zyrtare Web, në vlerën 410 mijë lekë. Për këtë zë ka përfunduar procedura e prokurimit dhe është në proces dizenjimi faqja nga operatori ekonomik fitues.

-Procedura e prokurimit për blerje karburanti u realizua 480 mijë lekë nga vlerë 900 mijë lekë, e cila ishte planifikuar në rregjistrin e parashikuar të prokurimit për vitin 2014.

-Është në proces likujdimi prokurimi për riparimin e automjetit të institucionit për vlerën 200 mijë lekë.

3.Investime

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit për periudhën janar - shtator është 830 mijë lekë. Ky program përbëhet nga një projekt “Paisje mobilje”. Ky fond u detajua për Zyrën e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor për plotësimin e nevojave për pajisje elektronike dhe mobilje për punonjësit e saj. Janë në proces procedurat për prokurimin e këtij fondi.

Formati nr.8 - Raporti i shpenzimeve sipas Programeve

Fondi i detajuar për këtë program për periudhën janar-shtator 2014, është 22,224 mijë lekë dhe realizimi 17,203 mijë lekë ose 77%. Ky program përbëhet nga tre produkte:

Produkti A- “Buxhet vjetor për Pushtetin Gjyqësor i administruar në mënyre eficiente dhe efektive”.

Në funksion të realizimit të këtij produkti shërben i gjithë buxheti i detajuar për Zyrën e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor për paga, sigurime shoqërore dhe shpenzime operative.

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit për periudhën janar - shtator është 830 mijë 22,224 mijë lekë dhe realizimi 17,203 mijë lekë ose 77%. Realizimi në këtë përqindje është rrjedhojë e mospërdorimit të plotë të fondit për “Shpenzime personeli” dhe shpenzime për “Mallra e Sherbime” për arsyet e sipërpërmendura.

Produkti B- “Paisje elektronike për zyra për ZABGJ”

Në këtë produkt periudhën janar- shtator është parashikuar një buxhet në vlerën 480 mijë lekë, për Zyrën e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor për plotësimin e nevojave për pajisje elektronike. Ka përfunduar procedura e prokurimit dhe është duke u lidhur kontrata.

Produkti C- “Mobilje për zyra për ZABGJ”

Në këtë produkt periudhën janar- shtator ishte parashikuar një buxhet në vlerën 350 mijë lekë, për Zyrën e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor për plotësimin e nevojave për mobilje. Ky fond me ndryshim në rregjistrin e parashikimit të prokurimeve publike, u transferua në produktin B “Paisje elektronike për zyra për ZABGJ”.

**DREJTORE
Luljeta LAZE**